URDHËR
Nr. 167, datë 8.9.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të VKM-së nr. 111, datë 2.3.2022, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", të ndryshuar; si dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë z. Ilir Bejtja, për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, të cilat nuk janë objekt koncesioni, sipas vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, duke filluar nga data 1.9.2022.
3. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Ilir Bejtja, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku